

Nr. 116 Prot.

Tiranë 31/01/2025

## URDHËR

Nr. 23, datë 31.01.2025

## PËR

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË EKSPERTIZËS PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS DHE TË AFATEVE TË RUAJTJES SË DOKUMENTEVE QË DISPONOHEN NË ARKIVËN E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT SI DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË DOKUMENTEVE TË VEÇUARA PËR ASGJESIM**

Në zbatim të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" si dhe Normës Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", neneve 5, 57 dhe 74 të Rregullores së Brendshme të Punës, miratuar me Urdhërin e Brendshëm nr. 182, datë 15.07.2016, si dhe mbështetur në propozimin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

## URDHËROJ:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ekspertizës për përcaktimin e vlerës dhe të afateve të ruajtjes së dokumenteve që disponohen në arkivën e institucionit të Avokatit të Popullit si dhe përgatitjen e listës së dokumenteve të veçuara për asgjesim.

2. Komisioni i Ekspertizës përbëhet nga:

- Fatbardh Zenelaj - Sekretar i Përgjithshëm
- Alket Jaupi - Ndihmëskomisioner
- Arben Gjoleka - Ndihmëskomisioner
- Anila Nepravishta - Ndihmëskomisionere
- Ina Goxhaj - Specialist Arkivist/Bibliotekar

3. Urdhëri nr.134, datë 25.06.2014 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ekspertizës për përcaktimin e vlerës dhe të afateve të ruajtjes së dokumenteve që disponohen në arkivën e institucionit të Avokatit të Popullit si dhe përgatitjen e listës së dokumenteve të veçuara për asgjësim”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Për ndjekjen e zbatimit të këtij Urdhëri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjehere.

AVOKATI I POPULLIT



ERINDA BALLANCA

